

UDHËZIM
Nr.1, datë 7.1. 2008

PËR DOKUMENTACIONIN E DOMOSDOSHËM PËR TË KËRKUAR LEJE MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të dispozitave të ligjit nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.249 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore”,

UDHËZOJ:

1. Për t’u pajisur me leje mjedisore për veprimtaritë me ndikim në mjedis, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, përgatisin dokumentet që kërkohen nga ligji “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.249 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore”.

2. Dokumentet për t’u pajisur me leje mjedisore konsistojnë në:

2.1.Kërkesën nga propozuesi për t’u pajisur me leje mjedisore, për projektin apo veprimtarinë që do të ushtrohet drejtuar ARM-së së qarkut ku do të zhvillohet veprimtaria. Kërkesa përmban emrin, adresën, selinë, statusin juridik të propozuesit dhe përshkrimin e shkurtër të projektit apo të veprimtarisë që do të ushtrohet.

2.2. Dokumentacionin ligjor që përbëhet nga:

a) Fotokopje e noteruar e regjistrimit të biznesit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

2.3. Dokumentacioni teknik (përshkrimi i aktivitetit, skica, harta etj.) që përbëhet nga:

a) Karakteristikat e projektit:

i) përshkrimi i teknologjisë, proceseve kryesore, kapaciteti, lëndët e para, energjia, lëndët ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare;

ii) program pune për ndërtimin dhe shfrytëzimin;

iii) aktivitete të tjera që mund të kërkohen si pasojë e projektit (p.sh.rrugë të reja, sigurim i ujit të pijshëm etj.).

b) Vendndodhja e projektit:

i) planimetria me kufijtë e projektit;

ii) harta dhe fotografi që tregojnë vendndodhjen e projektit;

iii) planet ekzistuese të përdorimit të territorit ku zhvillohet projekti.

c) Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis i hartuar nga ekspertë të certifikuar e të përzgjedhur nga kërkuesi i lejes mjedisore. Raporti i VNM-së hartohet sipas kërkesave dhe orientimeve të udhëzimit të ministrit nr.6, datë 27.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie”. Raportet e VNM-së të firmosen dhe vulosen nga hartuesit, si dhe të jepen të dhënat e licencës së ekspertëve të mjedisit të cetifikuar nga Ministria e Mjedisit (emrin, numrin e regjistrimit, datën e miratimit dhe numrin e vendimit të certifikatës).

d) Informacioni me të dhëna të konsultimit me publikun dhe palët e interesuara. Bashkëngjitur informacionit të jenë (procesverbale të takimeve, materialet e prezantuara, lista e personave të pranishëm, foto, që provojnë komunikimet e kërkuesit me publikun e zonës.

e) Deklaratë e përgatitur nga kërkuesi ku evidentohen kërkesat apo pretendimet e paraqitura nga publiku, OJF-të lokale (OJF që veprojnë në nivel kombëtar për projekte kombëtare), përfaqësues të pushtetit vendor apo palë të tjera të interesuara të ngritura gjatë prezantimit të veprimtarisë, konsultimeve me publikun, si dhe sugjerimet e kërkuesve dhe masat se si ato do të merren parasysh. Format i deklaratës i bashkëlidhet këtij udhëzimi si shtojca 1 e tij.

f) Plani i rehabilitimit për veprimtaritë që shfrytëzojnë burimet minerare (karrierat). Plani i rehabilitimit hartohet sipas kërkesave të vendimit nr.3, datë 21.6. 2006 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për rehabilitimin e shtretërve dhe të brigjeve të lumenjeve të dëmtuara nga shfrytëzimi i inerteve”, si dhe udhëzimit nr.3, datë 17.5.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”.

g) Plani i përballimit të emergjencave për veprimtaritë që përdorin, prodhojnë dhe magazinojnë (depozitim) lëndë të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve (si karburantët) apo substancat dhe preparatet e përshkruara në nenin 5 të ligjit nr.9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”. Plani i përballimit të emergjencave të përgatitet, sipas dispozitave të ligjit “Për emergjencat civile”.

2.4 Mendimin e këshillit të komunës dhe bashkisë mbi ushtrimin e veprimtarisë në territorin e tyre.

2.5 Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit për lejen mjedisore.

3. Ky udhëzim duhet t’u shpjegohet kërkuesve të lejes mjedisore dhe t’u vihet në dispozicion që të përgatisin saktë dhe në kohë sa më të shkurtër dokumentet për të kërkuar leje mjedisore.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e VNM dhe Lejeve, si dhe agjencitë rajonale të mjedisit.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, urdhri i brendshëm i ministrit nr. 137, datë 17.8.2004 “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMITTË UJËRAVE
Lufter XHUVELI